



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE PËR SHMANGIEN E
TATIMIT TE DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE
ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN”**

I. HYRJE

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin”.

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të Ministrisë për Financat dhe Ekonominë.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin.

Projektligji vjen pas miratimit në parim të tij përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.350, datë 23.05.2012 dhe nënshkrimit të saj në shkurt 2019, në Riad të Arabisë Saudite nga palët.

Marrëveshja synon mundësimin e shmangies së tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin dhe krijon një bazë të plotë ligjore për trajtimin tatimor të individëve apo personave juridikë shqiptarë apo sauditë, të cilët kanë aktivitete biznesi apo të ardhura të tjera që janë objekt i legjislacioneve tatimore të dy shteteve. Marrëveshje të tilla ndikojnë pozitivisht dhe stimulojnë marrëdhëniet ekonomiko-tregtare ndërkombëtare, si dhe kanë një rëndësi dhe ndikim të rëndësishëm në rritjen e aktiviteteve të biznesit të shoqërive shumëkombëshe, rritjen e lëvizjes së lirë ndërkombëtare të njerëzve, kapitaleve, mallrave e parave.

Më konkretisht përmes marrëveshjeve të tilla, shmanget rëndesa me tatim të dyfishtë pra për të njëjtën të ardhur të tatohet dy herë, për një individ apo një person juridik që ka aktivitet në të dy shtetet apo duke qenë rezident i njërit shtet që siguron të ardhura në shtetin tjetër, duke shmangur kështu edhe premisën për mospagim të tatimit dhe evazion fiskal.

Marrëveshja afekton personat që janë rezident në një ose dy shtete kontraktuese pra në Shqipëri apo në Mbretërinë e Arabisë Saudite.

Tatimet që përfshihen në këtë marrëveshje janë konkretisht tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin. Të tilla tatime do të konsiderohen tatimet mbi të ardhurat e të gjitha tatimeve të vendosura mbi të ardhurat e plota, mbi kapitalin ose mbi elementë të të ardhurave ose kapitalit, duke përfshirë tatimet mbi fitimin nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi totalin e pagave ose pagesat e bëra nga ndërmarrjet si dhe tatimet mbi vlerësimin e kapitalit.

Për Shqipërinë kjo marrëveshje do të shtrihet mbi këto tatime:

- i. Tatimin mbi të ardhurat duke përfshirë tatimin mbi fitimin e shoqërive, tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin e të ardhurave të kapitalit nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme ose të paluajtshme;
- ii. Tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël
- iii. Tatimi mbi pasurinë

Për Mbretërinë e Arabisë Saudite kjo marrëveshje do të shtrihet mbi këto tatime:

- i. Zakatin
- ii. Tatimin mbi të ardhurat përfshirë tatimin e investimit në gazin natyror

Kjo marrëveshje do të shtrihet edhe mbi tatime të njëjta apo thelbësisht të ngjashme të cilat do të vendosen pas nënshkrimit të marrëveshjes.

III. PËRMBAJTJA

Marrëveshja përbehet nga 30 nene.

- Në nenet 2, 4, 5 dhe 7 të marrëveshjes mundësohet përcaktimi i qartë i termave “rezidencë” për efekt fiskal si dhe i konceptit të “selisë së përhershme” të biznesit që një individ, duke përcaktuar tatimin e këtyre të ardhurave në shtetin ku ajo ndodhet apo ka vendin e saj fikse të biznesit.
- Në nenin 6 të saj përcaktohet e drejta e plotë tatimore e tatimit mbi të ardhurat nga pasuritë e paluajtshme (qerata, apo të ardhura të tjera) për Shtetin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme, pavarësisht nga rezidenca e tatimpaguesit apo pronarit.
- Neni 8 trajton të ardhurat nga transporti ndërkombëtar ku e drejta e plotë tatimore i jepet Shtetit ku ka rezidencën shoqëria ajrore apo detare që ushtron biznesin e transportit ndërkombëtar.
- Neni 9 i marrëveshjes trajton ndërmarrjet e asociara dhe trajton “transferim e çmimit” ose transferimi i fitimit.
- Nenet 10, 11 dhe 12, trajtojnë shmangia e tatimit të dyfishtë për të ardhurat nga dividendët, nga interesi dhe nga tatimi për liçenca (të ardhurat nga pronësia intelektuale – të drejtat e autorit, patentat).
- Neni 13 ka përcaktuar që e drejta tatimore për tatimin e të ardhurave nga shitja e pronave të paluajtshme i takon vendit ku ndodhen këto prona të paluajtshme, pavarësisht nga rezidenca e tatimpaguesit.
- Neni 14, trajton të ardhurat nga shërbimet personale të pavarura, shërbimet profesionale që një resident i një shteti kontraktues realizon në shtetin tjetër.
- Në nenet 15-22, trajtohen të ardhurat nga shërbime personale të varura, tarifat e drejtuesve të kompanive, të ardhurat e artistëve dhe sportistëve, të ardhurat nga pensionet, etj.
- Neni 23 dhe 24 trajtojnë të drejtën për tatimin e kapitalit (përfshirë tatimin mbi pronën), si dhe jepen mënyrat dhe procedurat e përgjithshme për eliminimin e tatimit të dyfishtë.
- Neni 26 përcakton dispozitat e përgjithshme të shkëmbimit të informacionit, ndërsa neni 27 përcakton se mos afektimin nga përcaktimet e kësaj marrëveshje në privilegjet financiare të anëtarëve të misioneve diplomatike apo posteve konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.
- Në nenin 29 jepen dispozitat e hyrjes në fuqi. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit lidhur me plotësimin e procedurave ligjore të Qeverive të Shteteve Kontraktuese dhe ka efekt në të dy Shtetet Kontraktuese në lidhje me tatimet që mbahen në burim, për të ardhurat që përftohen në 1 Janar ose pas 1 Janarit të vitit kalendarik të vitit pasardhës kur ka hyrë në fuqi Marrëveshja si edhe në lidhje me tatime të tjera mbi të ardhurat, për tatimet e vendosura për çdo vit tatimor duke filluar nga 1 Janari i vitit kalendarik pas vitit të hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

- Në nenin 30 parashikohet se kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi për një periudhë kohe të pakufizuar, por secila nga palët, pas një periudhë prej 5 vjetësh nga hyrja në fuqi, mund të njoftojë palën tjetër nëpërmjet rrugëve diplomatike për përfundimin e saj.

IV. NEVOJA PËR SAKTËSIM TË TEKNIKËS LEGJISLATIVE

Për teknikë legjislative sugjeroj, rregullimin e bazës ligjore në preambulë duke e saktësuar atë si më poshtë:

“Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,”

V. DISKUTIMI NË KOMISION

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit, për të shpjeguar nismën dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të përfaqësues të Ministrisë për Financat dhe Ekonominë. Deputetët në komision u informuan rreth qëllimit të projektligjit dhe kushteve të parashikuara në marrëveshje. Përfaqësuesit e ministrisë sqaruan se kjo marrëveshje, mundëson pikërisht shmangien nga tatimi i dyfishtë, duke i dhënë të drejtën për tatimin e të ardhurave të caktuara vetëm njërit shtet apo duke e ndarë këtë të drejtë midis të dy shteteve, por pa e rënduar subjektin me tatim të dyfishtë.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

KRYETARE

MIMI KODHELI